

## ANEKSI 8

### Aplikimi për autorizim për përdorimin e një regjimi të posaçëm, përveç transitit

Shënim: Referojuni shënimit shpjegues të duhur kur plotësoni këtë kërkesë

<b>1. Aplikuesi /numri NIPT</b>  1.a Adresa e-mail	E rezervuar për qëllime doganore		
<b>2. Proçedura/Regjimi doganor</b>	<b>3. Lloji i aplikimit</b>	<b>4. Pjesa vazhduese</b> <input type="checkbox"/> Po  <input type="checkbox"/> Jo	
<b>5. Vendi dhe lloji i llogarive / rregjistrimeve</b>			
<b>6. Periudha kohore e vlefshmërisë së autorizimit</b>  a     b			
<b>7. Mallrat që do të vendosen nën proçedurën doganore</b>			
<b>Kodi i NK</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>Vlera</b>
<b>8. Produkte të përpunuara</b>			
<b>Kodi i NK</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Koefiçienti i shfrytëzimit</b>	

<b>9. Detaje të përdorimit të planifikuar</b>	
<b>10. Kushtet ekonomike</b>	
<b>11. Zyra(t) doganore</b>	
<b>a</b>	<b>e vendosjes nën regjim</b>
<b>b</b>	<b>e mbylljes</b>
<b>c</b>	<b>e mbikqyrjes</b>
<b>12. Identifikimi</b>	<b>13. Periudha kohore e shkarkimit/rieksportit (muaj)</b>
<b>14. Procedura të thjeshtuara</b>	
a.	b.
<b>15. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve</b>	
<b>16. Informacion shtesë</b>	
<b>17.</b>	
<b>Emri .....</b>	
<b>Nënshkrimi .....</b>	<b>Data .....</b>

**Aplikimi për autorizim për regjimin e përpunimit pasiv**

**- formulari vazhdues**

<b>18. Sistemi</b>	
<b>19. Produkte zëvendësuese</b>	
<b>Kodi i NK</b>	<b>Përshkrimi</b>
<b>20. Informacion shtesë</b>	
<b>21.</b>	
<b>Emri .....</b>	<b>Data.....</b>
<b>Nënshkrimi .....</b>	

## **Shënime shpjeguese për formularët e procedurave të posaçme ndryshe nga transiti**

### **Kreu I**

#### **Informacion për plotësimin e formularëve**

##### **1. Aplikuesi/ numri i NIPT-it**

Emri dhe adresa e plotë e aplikuesit si dhe numri NIPT. Aplikuesi është personi për të cilin lëshohet autorizimi.

1.a) Shënoni një adresë e-maili (posta elektronike) e cila mund të përdoret për komunikim të mëtejshëm.

##### **2. Proçedura/regjimi doganor**

Shënoni procedurën doganore nën të cilën mallrat e listuara në kutinë 7, do të vendosen. Regjimet doganore përkatëse si më poshtë :

- Përdorim i veçantë përfundimtar, end-use
- Përdorim i veçantë lejim i përkohshëm
- Magazinin doganor
- Përpunim aktiv
- Përpunim pasiv

Shënim:

1. Nëse një aplikues aplikon për një autorizim për të përdorur më shumë se një regjim doganor, duhet të përdorë formularë të veçantë.

##### **3. Lloji i aplikimit**

Tregoni llojin e aplikimit duke përdorur të paktën një nga kodet e mëposhtme:

1 = aplikim për herë të parë

2 = aplikim për ndryshimin ose rinovimin e autorizimit (gjithashtu tregoni numrin e autorizimit të mëparshëm)

3 = aplikim për një autorizim pasues (përpunimi aktiv)

##### **4. Formularë vazhdues**

Tregoni numrin e formularëve vazhdues të vendosur bashkëlidhur.

Shënim:

Formularët e vazhdimësisë jepen/paraqiten për regjimet doganore të mëposhtme:  
magazininim doganor, përpunim aktiv (kur është e nevojshme) ose përpunim pasiv (kur është e nevojshme)

## **5. Vendi dhe lloji i llogarive/ rregjistrimeve**

Tregoni vendin ku mbahen ose janë të aksesueshme llogaritë kryesore për qëllime doganore. Specifikoni gjithashtu llojin e llogarive duke dhënë detaje për sistemin e përdorur.

Vendin ku regjistrimet janë mbajtur dhe llojin e rregjistrimeve për tu përdorur për procedura doganore. Rregjistrime do të thotë: Të dhënat që përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm dhe detaje teknike duke lejuar autoritetet doganore të mbikqyrin dhe kontrollojnë regjimin doganor.

Shënim:

Në rastin e importimit të përkohshëm kutia 5 është e nevojshme të plotësohet vetëm kur kërkohet nga autoritetet doganore.

## **6. Periudha kohore e vlefshmërisë së autorizimit**

Shënoni në kutinë 6.a. datën e kërkuar në të cilën autorizimi hyn në fuqi (ditën/muajin/vitin). Në parim, autorizimi hyn në fuqi në datën e lëshimit. Në këtë rast hidhni “datën e lëshimit”. Data e mbarimit të autorizimit mund të sugjerohet në Pikën 6.b.

## **7. Mallrat e vendosura nën regjim doganor**

Kodi i NK

Tregoni kodin tetë shifror të Nomenklaturës së Kombinuar.

Përshkrimi

Përshkrimi i mallrave nënkupton përshkrimin teknik dhe/ose tregtar.

Sasia

Shënoni sasinë e vlerësuar të mallrave që synohet të vendoset nën regjimin doganor .

Vlera

Shënoni vlerën maksimale të vlerësuar në LEKË ose EURO të mallrave të synuara për t'u vendosur nën regjimin doganor. Vlera mund të tregohet si shtesë edhe në një monedhë tjetër si p.sh USD.

Shënime:

Magazinimi doganor:

Nëse kërkesa mbulon një numër artikujsh të mallrave të ndryshme, ju mund të shënoni fjalën "të ndryshme" në nën-kutinë "Kodi i NK". Në këtë rast përshkruani natyrën e mallrave për t'u magazinur në nën-kutinë "Përshkrimi". Nuk është e nevojshme të jepen detaje për kodin e NK, sasinë dhe vlerën e mallrave.

Procedura e për përdorim të veçantë përfundimtar (end-use):

1. Nëse kërkesa ka të bëjë me mallra të tjera nga ato të pikës (2) më poshtë, ju duhet të shënoni në nën-kutinë "Kodi i NK" – kur është rasti – Kodin Taric (10 shifra ose 14 shifra).
2. Nëse kërkesa ka të bëjë me mallra nën dispozita speciale (Pjesa A dhe B) që përmbahen në Dispozitat Paraprake të Nomenklaturës së Kombinuar (mallra për kategori të caktuara të anijeve, varkave apo mjeteve të tjera të lundrimit dhe për shpime ose platforma prodhimi/aeroplanë civilë dhe mallra për përdorim në avionë civilë), kodet e NK nuk kërkohen. Aplikuesi duhet të theksojë në nën-kutinë "Përshkrimi" për shembull: "Avion civilë dhe pjesë për këtë regjim, pjesa B e NK". Më tej nuk është e nevojshme më të jepen detaje rreth kodit të NK, sasisë dhe vlerës së mallrave;

Përpunimi aktiv dhe pasiv:

Kodi i NK: jepet kodi katër shifror, megjithatë kur përdoren mallrat ekuivalente ose sistemi i shkëmbimit standart do të jepet kodi tetë shifror.

Përshkrimi: Përshkrimi tregtar dhe/ose teknik duhet të jetë mjaftueshëm i qartë dhe i detajuar për të mundësuar marrjen e një vendimi mbi aplikimin. Kur është planifikuar të përdoren mallra ekuivalente ose sistemi i shkëmbimit standart, jepni detaje rreth cilësisë tregëtare dhe karakteristikave teknike të mallrave.

## **8. Produkte të përpunuara**

Shënim i përgjithshëm: Shënoni detajet e të gjitha produkteve të përpunuara që rezultojnë nga operacionet duke treguar produktin kryesor të përpunuar ose produktin dytësor të përpunuar sipas rastit.

Kodi i NK dhe Përshkrimi : Shikoni komentet në Pikën 7.

Koeficienti i shfytëzimit: Tregoni koeficientin e shfytëzimit të vlerësuar ose koeficientin mesatar të shfytëzimit të vlerësuar, ose kur është rasti, metodën e përcaktimit të këtij koeficienti.

## **9. Detajet e aktiviteteve / përdorimit të planifikuar**

Përshkruani natyrën e aktiviteteve ose përdorimit të planifikuar (p.sh. detaje të operacioneve nën një kontratë pune përpunimi ose llojin e formave të zakonshme të trajtimit ) për t'u kryer tek

mallrat nën regjimin doganor. Tregoni gjithashtu vendin ku kryhen këto aktivitete. Kur duhet, tregoni emrin, adresën dhe funksionin e operatorëve të tjerë të përfshirë.

Shënime:

Në rast të procedurës për përdorim të veçantë përfundimtar “end-use” shënoni përdorimin përfundimtar të menduar dhe vendet ku mallrat do të vendosen për procedurën në fjalë. Kur duhet, tregoni koeficientin e shfrytëzimit.

Format e zakonshme të trajtimit lejojnë që mallrat e vendosura nën magazinim doganor ose një procedurë përpunimi të ruhen, përmirësojnë pamjen e tyre ose cilësitë tregtare ose për t’i përgatitur ato për shpërndarje apo shitje.

Në rast të lejimit të përkohshëm: jepni emrin dhe adresën e pronarit jo-shqiptar të mallrave të përshkruara në kutinë 7.

### **10. Kushtet ekonomike**

Në rastin e përpunimit aktiv duhet të japë arsyet për përmushjen e kushteve ekonomike. Në shumicën e rasteve një shqyrtim i kushteve ekonomike nuk është i nevojshëm. Megjithatë, në raste të caktuara një shqyrtim i tillë duhet të kryhet nga DPD.

### **11. Zyra(t) doganore**

Tregoni zyrën doganore të sugjeruar në përputhje me Listën e Zyrave Doganore.

Shënim: Në rast të përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use), kutia 11b nuk është e detyrueshme.

### **12. Identifikimi i mallrave**

Plotësoni në kutinë 12 me mënyrat e sugjeruara të identifikimit, psh:

- numri serial ose numri i prodhimit,
- vendosja e plumbçeve, vulave, shenjave kapëse ose shenjave të tjera dalluese
- marrja e mostrave, ilustrimet ose përshkrimet teknike
- kryerja e analizave
- dokument informimi
- mjete të tjera identifikimi (shpjegoni në kutinë 16 “informacion shtesë”)
- pa masa identifikuese (i përshtatshëm vetëm për lejim të përkohshëm)

### **13. Periudha kohore e shkarkimit (muajt)**

Shënoni periudhën kohore të vlerësuar si të nevojshme për kryerjen e operacioneve ose për përdorimin e regjimit të kërkuar. Periudha kohore fillon kur mallrat vendosen nën regjimin doganor dhe përfundon kur mallrat e vendosura nën regjim ose produktet e përpunuara vendosen

nën një regjim doganor pasues, rieksporohen ose vendosen në qarkullim të lirë me përjashtim total ose të pjesshëm nga detyrimi i importit pas përpunimit pasiv.

Shënime:

1. Në rastin e përdorimit të veçantë përfundimtar (end-use) periudha e cila është e nevojshme për ti shndërruar mallrat nën këtë procedurë ose për ti transferuar në një mbajtës tjetër të autorizimit.
2. Në rastin e magazinimit doganor periudha është e papërcaktuar, për këtë lëreni kutinë bosh.
3. Në rastin e përpunimit aktiv kur periudha kohore për mbylljen përfundon në një datë specifike për të gjitha mallrat e vendosura nën regjim për një periudhë kohore të përcaktuar, autorizimi mund të parashikojë që periudha kohore për mbyllje të shtyhet automatikisht për të gjitha mallrat ende nën regjim në atë datë. Nëse ky thjeshtim kërkohet, tregoni bazën ligjore dhe jepni detajet në kutinë 16.

#### **14. Tipi deklaratës:**

**Kutia 14.a)** Tregoni tipin e deklaratës që synohet të përdoret për vendosjen e mallrave nën regjim duke përdorur të paktën një prej kodeve të mëposhtme:

1. deklaratë standarte
2. deklaratë e thjeshtuar
3. hyrje në rregjistrimet e deklaruesit

**Kutia 14.b)** Tregoni tipin e deklaratës që synohet të përdoret për shkarkimin duke përdorur të paktën një prej kodeve të mësipërme.

Shënim:

Në rast të një aplikimi për përdorim të procedurës së veçantë përfundimtare end-use kutia 14 nuk plotësohet.

#### **15. Transferimi i të drejtave dhe detyrimeve**

Kur kërkohet një autorizim për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve jepni detajet.

#### **16. Informacion shtesë:**

Kur është e zbatueshme jepni informacionin shtesë si vijon:

Tipi garancisë

Garancia (po/jo)

Zyra doganore e garancisë

Mënyra e llogaritjes: në rastin e përpunimit aktiv nëse, në rastin e një borxhi doganor, shuma e detyrimeve të importit do të llogaritet sipas nenit 81/3 të kodit.

Jepni çdo informacion shtesë që konsideroni të rëndësishëm.

## **17. Emri/Nënshkrimi/Data**

Nëse një formular vazhdues është përdorur, plotësoni kutitë e përshtatshme 21, 22 dhe 26

Nëse nuk përdoret një formular vazhdues, vetëm pika 17 duhet të plotësohet.

## **Kreu II**

### **Shënime që kanë të bëjnë me detajet e plotësimit të formularëve vazhdues**

Formulari vazhdues “Regjimi magazinimit doganor”

**18. Tipi i magazinimit:** Jepni një nga tipet e mëposhtme:

Magazinë publike Tipi I

Magazinë publike Tipi II

Magazinë private

**19. Detaje rreth ambjenteve të magazinimit**

Jepni informacion të saktë rreth vendndodhjes së magazinimit ose ambjenteve apo çdo vendndodhje tjetër për magazinim doganor i cili mendohet të përdoret si ambient magazinimi.

**20. Afati kohor i paraqitjes së inventarit të mallrave**

Ju mund të bëni një sygjërim për afatin kohor të paraqitjes së inventarit të mallrave

**21. Shkalla e humbjes**

Jepni detaje kur është e përshtatshme ose shkallën e humbjes

**22. Magazinimi i mallrave jo nën regjim magazinimi**

Kodi NK dhe përshkrimi

Kur është planifikuar të magazinohen mallra jo nën regjim ose mallra ekuivalente në ambjentet e përdorura për magazinim të përbashkët shënoni kodin 8-shifror, përshkrimi teknik ose tregëtar i mallrave. Nëse është e aplikueshme specifikoni regjimin doganor të çdo malli.

**23. Format e zakonshme të trajtimit**

Plotësoni nëse format e zakonshme të trajtimit janë parashikuar.

## **24. Zhvendosja e përkohshme**

Qëllimi :

Plotësoni nëse zhvendosje të përkohshme janë parashikuar.

### **Formulari vazhdues për “Regjimin e Përpunimit Aktiv”**

#### **18. Mallrat ekuivalente**

Nëse është planifikuar të përdoren mallra ekuivalente jepni kodin 8- shifror të NK, cilësitë tregtare dhe karakteristikat teknike të mallrave ekuivalente në mënyrë që autoritetet doganore të bëjnë krahasimin e nevojshëm ndërmjet mallrave të importuara dhe mallrave ekuivalente. Kodet në kutinë 12 mund të përdoren si sygjerim për këtë qëllim. Nëse mallrat ekuivalente janë në një stad më të avancuar të prodhimit se sa mallrat e importuara jepni informacionin e duhur në kutinë 21.

#### **19. Eksportimi paraprak**

Kur planifikohet të përdoret sistemi i eksportimit paraprak tregoni periudhën kohore brenda së cilës mallrat jo-shqiptare duhet të deklarohen për përpunim aktiv duke llogaritur kohën e kërkuar për sigurimin e mallrave dhe transportin e tyre në RSh.

#### **20. Çlirimi për qarkullim të lirë duke përdorur dokumentin e mbylljes**

Nëse kërkohet që produktet e përpunuara ose mallrat e vendosura nën procedurë duhet të çlirohen për qarkullim të lirë pa formalitetet e parashikuara në nenin 155/1 të kodit.

#### **21. Informacioni shtesë**

Tregoni të gjithë informacionin shtesë të konsideruar të nevojshëm për sa i përket kutive 18 deri 20.

### **Formulari vazhdues për “Regjimin e Përpunimit Pasiv”**

#### **18. Sistemi**

Nëse synohet vendosni kodin e përshtatshëm:

1 = sistemi shkëmbimit standard pa import paraprak

2= sistemi i shkëmbimit standard me import paraprak

3= përpunim pasiv IM/EX në përputhje të nenit 201/2/ç të kodit.

## **19. Produkte zëvendësuese**

Kur planifikohet të përdoret sistemi i shkëmbimit standart (i mundur vetëm në rast të riparimit), tregoni kodin tetë shifror të NK, cilësinë tregtare dhe karakteristikat teknike të produkteve zëvendësuese për të mundësuar autoritetet doganore të bëjnë krahasimin e nevojshëm ndërmjet mallrave për eksport të përkohshëm dhe produkteve zëvendësuese. Kodet e dhëna në kutinë 12 jepen si sygjerim për këtë qëllim.

## **20. Informacioni shtesë**

Tregoni të gjithë informacionin shtesë të konsideruar të nevojshëm për sa i përket kutive 18 deri 19.

Nëse është planifikuar të përdoren mallra ekuivalente jepni kodin 8- shifror të NK, cilësitë tregtare dhe karakteristikat teknike të mallrave jo shqiptare në mënyrë që autoritetet doganore të bëjnë krahasimin e nevojshëm ndërmjet mallrave të eksportuara përkohësisht dhe mallrave ekuivalente. Kodet në kutinë 12 mund të përdoren si sygjerim për këtë qëllim.